



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE I NAUKE
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Në bazë të nenit 12, paragrafit 1 të Rregullores nr. 42/26 të datës 08.06.2026 për Subvencionimin e Punës Kërkimore-Shkencore të Punonjësve të IPK-së, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës, IPK shpall këtë:

THIRRJE TË BRENDSHME PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONIMIN E PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE

I. Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështetja e zhvillimit profesional dhe shkencor të punonjësve të IPK-së, rritja e numrit dhe cilësisë së publikimeve shkencore, promovimi i pjesëmarrjes në konferenca dhe aktivitete shkencore, si dhe sigurimi i një menaxhimi transparent dhe efektiv të mjeteve financiare të ndara për subvencione.

II. Kategoritë e subvencionimit dhe limitet financiare

Punonjësit e IPK-së mund të aplikojnë për mbështetje financiare në këto kategori:

1. Publikime në revista shkencore, sipas përcaktimeve dhe limiteve financiare të vendosura në Nenin 16 të Rregullores për Subvencionimin e Punës Kërkimore-Shkencore të Punonjësve të IPK-së.
 - 1.1. Shënim i rëndësishëm:
 - Nuk subvencionohen publikimet në revista ose te botues që, pas verifikimit profesional të dokumentuar, nuk plotësojnë standardet e transparencës, recensimit shkencor, etikës botuese dhe identifikimit të qartë të botuesit.
 - Verifikimin për publikimet në revista që konsiderohen si "grabitqare" e bën Këshilli Shkencor i IPK-së, me kërkesë nga drejtori i IPK-së.
2. Pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, sipas përcaktimeve dhe limiteve financiare të vendosura në Nenin 17 të Rregullores për Subvencionimin e Punës Kërkimore-Shkencore të Punonjësve të IPK-së.
 - 2.1. Mbështetja financiare për këtë kategori përfshin pagesat për: pjesëmarrje në konferencë, biletë të udhëtimit (klasë ekonomike) dhe akomodimin.

3. Projekte të veçanta hulumtuese dhe libra shkencorë, sipas përcaktimeve dhe limiteve financiare të vendosura në Nenin 18 të Rregullores për Subvencionimin e Punës Kërkimore-Shkencore të Punonjësve të IPK-së.

III. Kriteret e përgjithshme për aplikuesit

Për të qenë përfitues i subvencionit, aplikuesi duhet të plotësojë këto kriteret e përgjithshme:

1. Të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në IPK.
2. Të realizojë aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me planin e punës dhe fushën veprimtarinë e IPK-së.
3. Të prezantoj dëshmi që projekti ose aktiviteti për të cilin kërkohet subvencionimi të mos jetë i financuar paraprakisht nga burime të tjera institucionale.
4. Të aplikoj për publikime në revista shkencore të realizuara gjatë vitit 2026, para datës së shpalljes së kësaj thirrje dhe deri në datën e mbylljes së aplikimit me këtë thirrje.
5. Të respektojë standardet e etikës dhe integritetit akademik.
6. Kriteret tjera të përcaktuara sipas rregullores në fuqi.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Aplikuesi për subvencionim duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për subvencionim.
2. Formularin e plotësuar të aplikimit (sipas kategorisë specifike të përcaktuar në Rregullore).
3. Dokumentet mbështetëse sipas llojit të aktivitetit (p.sh. ftesa për konferencë, abstrakti i pranuar, programi, ose artikulli i pranuar për botim dhe të dhënat mbi revistën/faturën).
4. Deklaratën e nënshkruar që vërteton saktësinë e të dhënave dhe që tregon se aktiviteti ose shpenzimi nuk është financuar ose rimbursuar, plotësisht apo pjesërisht, nga një burim tjetër publik, institucional, donator ose projekt.
5. Dokumentacionin në përputhje me rregulloren për Subvencionim, sipas kategorive të subvencionimit.

V. Kufizimet dhe mënyra e realizimit

1. Përmes kësaj Thirrjeje, nuk subvencionohen aktivitetet, publikimet ose punët për të cilat aplikuesi ka përfituar ose ka të drejtë të përfitojë honorar, kompensim mbi normë apo pagesë tjetër sipas Rregullores për veprimtarinë botuese dhe Rregullores për honorarët e IPK-së
2. Një punonjës i IPK-së nuk mund të përfitojë më shumë se dy (2) subvencione brenda një viti fiskal, pavarësisht kategorisë.

3. Subvencionimi për publikime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore, realizohet përmes rimbursimit të shpenzimeve të bëra, pas dorëzimit të raportit narrativ dhe dokumentacionit financiar përkatës (faturat, dëshmitë e pagesës, biletat, konfirmimet dhe raporti përfundimtar narrativ/financiar).
 - 3.1. Rimbursimi realizohet brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit për suvencionimin e aktivitetit të përfunduar dhe i cili i plotëson kriteret siç parashihet me rregulloren për Subvencionim.
 - 3.2. Për rimbursim, aplikuesi duhet të dorëzojë faturën - dëshminë e pagesës së publikimit së bashku me transaksionin bankar përkatës.
 - 3.2.1. E njëjta faturë ose i njëjti shpenzim nuk mund të rimbursohet më shumë se një herë, pavarësisht numrit të autorëve ose bashkautorëve.
 - 3.3. Për subvencione të pjesëmarrjes në konferencë, aplikuesi duhet të dorëzojë:
 - faturën e biletës së udhëtimit, (në rast të fluturimit, bileta duhet të jetë klasë ekonomike),
 - faturën e akomodimit gjatë qëndrimit në konferencë, si dhe
 - dëshminë e pagesës së tarifës (fee) për pjesëmarrje në konferencë së bashku me transaksionin bankar përkatës.
4. Subvencionimi për projekte të veçanta dhe libra shkencorë realizohet përmes rimbursimit pas miratimit nga Këshilli Shkencor i IPK-së, në përputhje me planin e detajuar buxhetor të projektit të miratuar.
 - 4.1. Bartësi i projektit, përfitues i subvencionimit për projekte të veçanta dhe libra shkencorë dorëzon raport dhe financiar për shpenzimet e bëra në lidhje me projektin, sipas formatit të miratuar nga Këshilli Shkencor i IPK-së.
 - 4.2. Për libra shkencorë aplikuesi dorëzon edhe të dhëna nga recensinimi shkencor, ISBN, botuesin, tirazhin ose publikimin në formatin elektronik, autorësinë dhe pjesën e secilit bashkautor.
5. Të gjitha faturat e pagesave duhet të kenë edhe kuponin fiskal ose një dokument tjetër ekuivalent i vlefshëm sipas legjislacionit të vendit ku është lëshuar.

VI. Procedura e vlerësimit dhe vendimmarrja

1. Shqyrtimi i aplikimeve bëhet nga Komisioni Vlerësues brenda 30 ditëve të punës nga dorëzimi i aplikimit apo mbyllja e thirrjes.
2. Para fillimit të vlerësimit, secili anëtar i Komisionit nënshkruan deklaratën e konfidencialitetit, paanshmërisë dhe mungesës së konfliktit të interesit.
 - 2.1. Anëtari që ka konflikt interesi përjashtohet nga shqyrtimi dhe vendimmarrja për aplikimin përkatës.
 - 2.2. Anëtari që ka konflikt interesi zëvendësohet nga drejtori i Institutit, me vendim të veçantë.

3. Vendimi përfundimtar për subvencionim merret nga Drejtori i IPK-së, bazuar në rekomandimin e Komisionit.
4. Aplikuesi ka të drejtë ankese në Këshillin Drejtues brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga dita e pranimi të vendimit individual. Këshilli Drejtues vendos për ankesën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës. Vendimi mbi ankesën është përfundimtar në procedurën e brendshme administrative.”
5. Rezultatet e vendimmarrjes publikohen në ueb-faqen zyrtare të IPK-së brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar.
 - 5.1. Në ueb-faqe publikohen emri i përfituesit, kategoria, titulli i aktivitetit dhe shuma e miratuar.

VII. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve

Aplikimet mund të dorëzohen në formatin fizik pranë Zyrës kryesuesit të komisionit apo të dërgohen në adresën elektronike: institutipedagogjik@gmail.com, me **subjekt**: Aplikim për kategorinë e caktuar të subvencionimit, varësisht se për cilën kategori bëhet aplikimi.

Afati i fundit për aplikim është deri më datë: 20.11.2026, në orën 16:00.

U.d. i Drejtorit të IPK-së

Dr. sc. Murteza Osdautaj

